

Besimi dhe perceptimi i klientëve për bankat dhe sektorin bankar shqiptar

Tetor-nëntor 2022



Objektivat e studimit

1 Përdorimi dhe qëndrimet e bankave.

2 Perceptimi dhe kënaqësia me sistemin bankar.

3 Krahasimi me valët e mëparshme.

Përmbajtja

- Metodologjia
- Konteksti i studimit
- Përmbledhja ekzekutive
- Rezultatet e studimit
- Shtojca

Rezultatet janë paraqitur:

- Në nivel agregat dhe më pas analizohen sipas parametrave të mëposhtëm: gjinia, urbaniteti, moshë, rajoni, niveli arsimor dhe përvoja me bankën kryesore.
- Më tej, gjetjet aktuale krahasohen me valët e mëparshme të studimit.

Metodologjia

Detajat e kampionit dhe afati kohor

- Ky studim përmbledh 1000 intervista me individë të moshës 18 vjeç e lart, të mbledhura nga e gjithë Shqipëria me një shpërndarje përfaqësuese.
- 767 intervista janë realizuar nëpërmjet IDRApoll (www.idrapoll.com) dhe pjesa tjetër, 233 intervista, përmes CATI (Intervistë Telefonike me Asistencë Kompjuterike).
- Rezultatet janë përfaqësuese në nivel kombëtar dhe intervistat u kryen përmes përzgjedhjes së rastësishme.
- Korniza kohore e mbledhjes së të dhënave:
 - Vala aktuale: Tetor 2022 (N1000)
 - Vala e dytë: Dhjetor 2019 (N400)
 - Vala e parë: Qershor 2019 (N600)
- Marzhi i gabimit (N1000): $\pm 3.1\%$

| Qarku | Intervistat (Kampioni) | | |
|-----------------|------------------------|---------------|---------------|
| | <i>Gjithsej</i> | <i>Qyteti</i> | <i>Fshati</i> |
| Berat | 55 | 20 | 35 |
| Dibër | 36 | 10 | 26 |
| Durrës | 90 | 70 | 20 |
| Elbasan | 103 | 43 | 60 |
| Fier | 113 | 53 | 60 |
| Gjirokastrë | 30 | 20 | 10 |
| Korcë | 75 | 30 | 45 |
| Kukës | 30 | 13 | 17 |
| Lezhë | 45 | 25 | 20 |
| Shkodër | 75 | 45 | 30 |
| Tiranë | 291 | 205 | 86 |
| Vlorë | 57 | 44 | 13 |
| Gjithsej | 1000 | 578 | 422 |

Konteksti i sistemit bankar 2019-2022 (I/I)

- Përmbledhja e zhvillimeve të fundit të sistemit financiar në Shqipëri, synon të thellojë të kuptuarit tonë për ndryshimet që kanë ndikuar në perceptimin e njerëzve për bankat e nivelit të dytë.
- Për shkak të krizës të shkaktuar nga COVID-19, situatat e paprecedentë në dy vitet e fundit kanë shënuar një tronditje historike në ekonominë në mbarë botën, duke detyruar qeveritë të ndërmarrin masa ekstreme dhe të ndërpresin një sërë aktivitete publike dhe private.
- Qeveria shqiptare shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në mars 2020, e cila ndikoi në disa aktivitete ekonomike.
- Kërkesa e reduktuar dhe çmimet ndërkombëtare kanë rritur normën e inflacionit, e cila është reflektuar në një pritje për norma më të larta interesi dhe kthim më të lartë nga investimet në tregjet ndërkombëtare.
- Si rezultat i veprimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve të tjera financiare, BSH pohon se tkurrja e ekonomisë shqiptare është shoqëruar me ulje të pasigurisë dhe rritje të kërkesës së brendshme dhe të jashtme.
- Krahas krizave shëndetësore që ndikuan në ekonominë e përgjithshme, sistemi financiar në Ballkanin Perëndimor raportohet të ketë funksionuar në mënyrë të qëndrueshme, duke hyrë në këtë krizë me agregate të fortë kapitali dhe likuiditeti.
- Bashkimi i bankave dhe revokimi i licencave në Shqipëri kanë forcuar sistemin nëpërmjet konsolidimit.
- Ndërsa në Mal të Zi, dy banka me kapital të pamjaftueshëm iu nënshtruan procesit të likuidimit.

- Në Kosovë, fillimi i përmbaruesve private ka sjell uljen e kredive me probleme brenda dhe jashtë bilancit, duke shënuar nivelin më të ulët historik prej 2 për- qind ndaj kredive gjithsej në fund të vitit 2019.
- Edhe pse kreditë kanë rënë në të gjitha vendet, ato mbeten në nivele të larta në Shqipëri dhe Bosnjë dhe Hercegovinë. Parashikohet që njerëzit të dukeshin më të tërhequr nga investimet e mëdha si blerja e pasurive të paluajtshme duke pasur parasysh nivelet në rënie të produktivitetit kombëtar dhe punësimit. Sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë, familjeve shqiptare vitin e kaluar iu dhanë 215 milionë euro kredi për shtëpi, gjithsej 26.5 miliardë lekë.
- Aq më tepër kur ky investim mbështetet nga marrja e kredive të konsiderueshme, afatgjata, si kreditë hipotekare.
- Në vitin 2021 dhe 2022, disa sulme kibernetike ndodhën në Shqipëri, duke përfshirë kolapsin e sistemit e-Albania, TIMS, dhe rrjedhjen e të dhënave personale si nga sektori publik ashtu edhe nga ai privat që solli më pas paralizimin e shumë shërbimeve dhe transaksioneve publike.
- Këto ngjarje kanë ndikuar në përmirësimet e planifikuara teknologjike në institucionet publike dhe private.
- Edhe pse institucionet bankare shqiptare janë të konsoliduara dhe shumë profesionale, sektori bankar renditet në mënyrë jokonsistente me normën më të ulët për tregtinë elektronike në rajon.
- Megjithatë, sipas Raportit të Bankës së Shqipërisë, përdorimi i kartave të debitit është rritur në vitin 2021.
- Në tetor 2021 u realizua operacionalizimi i skemës ndërbankare për “Debitim Direkt” dhe në janar 2022 filloi të funksionojë sistemi AIPS EURO për shlyerjen e pagesave në euro brenda vendit për klientët e bankave.

Përmbledhja ekzekutive

Besimi dhe perceptimi i klientëve për bankat dhe sektorin bankar shqiptar



Përmbledhja ekzekutive (I/VI)

Përdorimi i produktit

- Rezultatet tregojnë se **karta e debitit është produkti më i përdorur bankar** me 52% të përdoruesve të bankave që kanë deklaruar se i përdorin aktualisht. Produkti i dytë më i përdorur është karta e kreditit me 21% të përdoruesve të bankave duke u ndjekur nga llogaria e kursimit me 17% të përdoruesve të bankave.
- Meshkujt, përdoruesit e bankave në Tiranë, të moshuarit, përdoruesit e bankave me më shumë përvojë me bankën e tyre kryesore dhe përdoruesit e bankave që përdorin produkte bankare digjitale janë ata që aktualisht përdorin produkte bankare më shumë se të tjerët.
- Kur krahasohen rezultatet me studimet e mëparshme, vërehet një rritje në përdorimin e kartave të debitit (52% në studimin e 2022, kundrejt 44% në valën e dytë dhe 46% në valën e parë), por ka pasur një rënie në përdorimin e produkteve të tjera bankare.

Siguria në industrinë

- Gjetjet e anketës tregojnë se **sektori bankar është industria më e besueshme**, krahasuar me industrinë e tjera (34% e përdoruesve të bankave besojnë “plotësisht” ose “disi”). Nuk ka asnjë ndryshim domethënës nga studimi i mëparshëm.
- Femrat, përdoruesit e bankave që jetojnë në zonat e fshatit, të moshuarit, përdoruesit e bankave me shkollë të mesme ose arsim më të ulët, dhe përdoruesit e bankave që nuk jetojnë në Tiranë kanë besim më të lartë në shumicën e industrive, si sektori bankar, Banka e Shqipërisë, institucionet arsimore etj.
- Kur u pyetën për nivelin e besimit në bankën e tyre kryesore, të dhënat tregojnë se ka një nivel të lartë besimi (5.6 nga 7). Nuk ka asnjë ndryshim të rëndësishëm me të dhënat nga studimi i mëparshëm.
- Përdoruesit e bankave që jetojnë në zonat e fshatit, me shkollë të mesme ose arsim më të ulët, dhe ata që jetojnë jashtë Tiranës priren t'i besojnë më shumë bankës së tyre kryesore.

Përmbledhja ekzekutive (II/VI)

Transparenca e bankës

- Shumica e përdoruesve të bankave bien dakord për **transparencën e bankës së tyre**. Rreth 79% e përdoruesve të bankave bien “shumë dakord” ose “deri diku dakord” se *“Informacioni nga banka është qartësisht i lexueshëm dhe i kuptueshëm”*.
- Deklarata me të cilën përdoruesit e bankave pajtohen më së paku është *“Banka ofron akses në informacionin e nevojshëm për të zbuluar nëse është financiarisht i shëndoshë”* (56% “shumë dakord” dhe “deri diku dakord”).
- Nuk ka një ndryshim të konsiderueshëm në nivelin e marrëveshjes për transparencën e bankës, krahasuar me studimin e mëparshëm.
- Përdoruesit e bankave që jetojnë në zonat e fshatit, ata me shkollë të mesme ose nivel më të ulët arsimor dhe përdoruesit e bankave që jetojnë jashtë Tiranës janë të pritur të bien dakord më shumë për transparencën e bankës.

Vlerësimi i sektorit bankar

- Përdoruesve të bankave iu prezantuan disa deklarata për të vlerësuar përvojën e tyre me bankën e tyre kryesore. Pothuajse të gjithë (93% “shumë dakord” ose “deri diku dakord”) përdoruesit e bankave pajtohen që banka e tyre kryesore *“është lehtësisht e aksesueshme në internet (mobile/online banking)”*.
- Deklarata e dytë më e pranuar (54% “shumë dakord” ose “deri diku dakord”) për bankën e tyre kryesore është *“Ajo komunikon në një gjuhë që unë kuptoj”*.
- Niveli më i ulët i pajtueshmërisë (54% “shumë dakord” ose “deri diku dakord”) është në deklaratën *“Më ndihmon të marr vendime financiare”*. Nuk shihet ndonjë ndryshim i rëndësishëm në krahasim me studimin e mëparshëm (vetëm që banka e tyre tani është më e lehtë për t'u aksesuar online).
- Përdoruesit e bankave që jetojnë në zonat e fshatit dhe jashtë Tiranës janë të prirur të japin një nivel më të lartë vlerësimi për sektorin bankar.

Përmbledhja ekzekutive (III/VI)

Kontakti me bankën

- Gjetjet e anketës tregojnë se ende, si në studimet e mëparshme, shumica e njerëzve (74%) **kontaktojnë drejtpërdrejt bankën** duke shkuar në degë.
- Pothuajse gjysma e përdoruesve të bankave (46%) kontaktojnë bankën përmes **aplikacionit të mobile banking**.
- Mënyrat e tjera që përdoruesit e bankave kontaktojnë bankën e tyre janë me *Telefonatë/SMS* (17%), *në faqen kryesore të bankës* (13%), etj.
- Më shumë përdorues bankash që jetojnë në zona të qytetit, jashtë Tiranës, përdorues të rinj të bankave (më pak se 44 vjeç), me arsim universitar ose më të lartë, përdoruesit e bankave me më shumë përvojë me bankën e tyre kryesore, sesa qytetarët e tjerë, kontaktojnë bankën përmes aplikacionit bankar në celular (smartphone, tablet).

Ndershmëria e bankës

- Përdoruesve të bankave iu prezantuan disa deklaratë për ndershmërinë e bankës. Rezultatet nga anketa tregojnë se deklarata me të cilën të anketuarit pajtohen më shumë është *"Me bankën mund të jem i sigurt se do të marr shërbimin për të cilin paguaj"* (75% bien "shumë dakord" ose "deri diku dakord").
- Më pak e vlerësuar është *"Banka kontribuon duke investuar në projekte dhe sponsorizime për të mirën e të gjithë komunitetit"* (42% "shumë dakord" ose "deri diku dakord"), që do të thotë se të anketuarit nuk mendojnë se ky është rasti i bankës së tyre kryesore. Nuk ka asnjë ndryshim domethënës kur krahasohet me të dhënat nga studimi i mëparshëm.
- Përdoruesit e bankave që jetojnë në zonat e fshatit, me shkollë të mesme ose nivel më të ulët arsimor, dhe përdoruesit e bankave që jetojnë jashtë Tiranës priren të japin një vlerësim më të lartë për deklaratat që lidhen me ndershmërinë e bankës.

Përmbledhja ekzekutive (IV/VI)

Shpeshtësia e kontaktit

- Edhe pse mënyra më e përdorur e kontaktit është duke shkuar në degë, shpeshtësia e këtij kontakti është më e ulëta në krahasim me **kontaktin digjital**. Vetëm 27% e atyre që kontaktojnë bankën e tyre duke shkuar në degë, e bëjnë këtë të paktën disa herë në muaj; krahasuar me 84% të atyre që kontaktojnë bankën e tyre përmes mobile banking, të cilët e bëjnë këtë të paktën disa herë në muaj; dhe 76% e atyre që kontaktojnë bankën përmes online banking e bëjnë këtë të paktën disa herë në muaj.
- Krahasuar me studimin e mëparshëm, ka një shpeshtësi më të ulët të kontaktit me bankën duke shkuar në degë dhe nëpërmjet mobile banking, ndërkohë që është një rritje e shpeshtësisë së kontakteve përmes online banking.

Ankesat

- Rreth 9% e përdoruesve të bankës kanë dorëzuar një ankesë në bankën e tyre.
- Nga ana tjetër, 80% nuk kishin ankesa në valën 2022 të studimit, krahasuar me 78% në studimin e mëparshëm dhe 68% në studimin e valës së parë. Sipas studimit të vitit 2022, rreth 33% e përdoruesve të bankave që kanë dorëzuar një ankesë në bankën e tyre, janë "shumë të zhgënjyer" ose "të zhgënjyer" me mënyrën se si është zgjidhur ankesa e tyre më e fundit, krahasuar me 44% në valën e parë të studimit.
- Të pyetur për mënyrat e preferuara për t'u ankuar në bankën e tyre, nëse duan të ankohen, 63% e përdoruesve të bankave do të preferonin të ankoheshin drejtpërdrejt duke shkuar në bankë.
- Më pak të anketuar nga Tirana, me arsim universitar ose më të lartë, përdorues bankash që jetojnë në zona të qytetit dhe meshkujt, preferojnë të shkojnë fizikisht në bankë se të tjerët.

Përmbledhja ekzekutive (V/VI)

Përdorimi digjital

- Rreth gjysma e përdoruesve të bankave (50%) përdorin **produkte të bankingut digjital**, ku 39% përdorin vetëm mobile banking, 4% vetëm online banking dhe 7% përdorin të dyja.
- Nga ata që përdorin të dyja, 73% aplikojnë më shpesh mobile banking, ndërsa 27% online banking.
- Nuk vërehen diferenca të rëndësishme midis studimeve të mëparshme për përqindjen e përdorimit të bankingut digjital, përveç se më shumë të anketuar përdorin mobile banking dhe më pak online banking.
- Përdoruesit më të vjetër të bankave, me shkollë të mesme ose nivel më të ulët arsimor, që jetojnë në zona të fshatit dhe jashtë Tiranës përdorin shumë më pak produkte bankare digjitale, krahasuar me të tjerët.

- Shumica e përdoruesve digjital të bankave janë të kënaqur duke përdorur mobile/online banking (84% e përdoruesve të mobile banking janë “shumë të kënaqur” ose “të kënaqur” kur përdorin mobile banking dhe 83% të përdoruesve online janë “shumë të kënaqur” ose “të kënaqur”) kur përdorin online banking.
- Pothuajse të gjithë përdoruesit digjital të bankave, përdorin aplikacionin e mobile/online banking për të kontrolluar balancën e llogarisë/kartën e debitit ose të kreditit (98%).
- Gjysma e përdoruesve të produktit digjital (51%), përdorin aplikacionin mobile/online banking për transferta bankare.
- Rreth 42% e përdoruesve të produkteve bankare digjitale i përdorin ato për pagesat utilitate dhe/ose pagesat e gjobave.

Përmbledhja ekzekutive (VI/VI)

NPS – Rezultati neto i promovuesit

- Gjatë llogaritjes së rezultatit neto të promovuesit, rezultatet tregojnë se vlerësimi për sektorin bankar në Shqipëri është 28.
- Ka një **përmirësim të dukshëm** nga studimet e mëparshme (NPS e barabartë me 28 në studimin e 2022, krahasuar me 24 në studimin e valës së dytë dhe 9 në studimin e valës së parë).
- Përdoruesit e bankave që jetojnë jashtë Tiranës, me më shumë eksperiencë me bankën e tyre kryesore, si dhe femrat, të moshuarit (më të vjetër se 44 vjeç), përdoruesit e bankave që jetojnë në zonat e fshatit dhe përdoruesit e bankave me shkollë të mesme ose nivel më të ulët arsimor janë më të prirur për të promovuar bankën e tyre kryesore se të tjerët (ata kanë një vlerësim më të lartë të NPS-së, krahasuar me grupet e tjera).
- Rreth gjysma e përdoruesve të bankave (49%) janë të prirur për të promovuar bankën e tyre kryesore, ndërsa 21% nuk do t'ua rekomandonin bankën e tyre kryesore kolegëve apo të njohurve.
- Arsyeja kryesore për të promovuar bankën e tyre kryesore, sipas gjetjeve të sondazhit, është siguria dhe besueshmëria e saj (34% e përdoruesve të bankave janë të prirur të promovojnë bankën e tyre kryesore).
- Arsyeja e dytë më e përmendur është korrektësia dhe cilësia e shërbimeve bankare (26%).
- Nga ana tjetër, arsyeja kryesore që 12% e të anketuarëve nuk do ta rekomandonin bankën e tyre kryesore është për shkak të kostove të ndryshme bankare dhe komisioneve të larta.
- Arsyet e tjera të përmendura kritikuese janë mungesa e korrektësisë/cilësia e dobët e shërbimeve bankare (11%) dhe mungesa e teknologjisë/inovacionit (11%).

I. Rezultatet kryesore

(Slide 14-59)

II. Shtojca


(Slide 60-115)

1. Përdorimi i produktit
2. Siguria në industri
3. Vlerësimi i sektorit bankar në Shqipëri
4. Kontakti me bankën
5. Përdorimi i produkteve bankare digjitale
6. Ankesat
7. NPS
8. Demografia



Përdorimi i produkteve bankare

Sipas totalit dhe gjinisë




Cilin nga produktet bankare përdorni aktualisht?

- Sipas gjetjeve të anketës, karta e debitit është produkti më i përdorur (52% e përdoruesve të bankës deklarojnë se e përdorin aktualisht).
- Të dhënat tregojnë se produkti i dytë më i përdorur është karta e kreditit (21%), ndërsa e treta është llogaria e kursimit (17%).
- Megjithatë, shqiptarët ende përdorin pak karta debiti, pasi pritet që shumica e njerëzve që janë përdorues të bankave ta përdorin kartën e debitit.
- Meshkujt deklarojnë se aktualisht përdorin më shumë produkte bankare sesa femrat.
- Ka një ndryshim të rëndësishëm në përdorimin e kartës së debitit midis meshkujve dhe femrave (58% e meshkujve përdorin kartën e debitit, kundrejt 46% të femrave).

Përdorimi i produkteve bankare

Sipas rajonit




Cilin nga produktet bankare përdorni aktualisht?

- Duke analizuar të dhënat e ndara sipas rajoneve, vihet re se përdoruesit e bankave nga Tirana kanë më shumë gjasa të përdorin kartë krediti sesa të anketuarit nga qarqet e tjera, përkatësisht 25% në Tiranë kundrejt 19% në qarqe të tjera.
- E njëjta gjë vlen edhe për përdorimin e llogarive të kursimit, kredive konsumatore/personale, kredive për shtëpi dhe letrave me vlerë të qeverisë.
- Nga ana tjetër, të anketuarit nga qarqet e tjera (jo nga Tirana) kanë më shumë gjasa të përdorin kartën e debitit (49% në Tiranë, kundrejt 52% në qarqet e tjera).

Përdorimi i produkteve bankare

Krahasim me valët e kaluara

Cilin nga produktet bankare përdorni aktualisht?




- Sipas rezultateve të anketës, ka një rritje të numrit të personave që përdorin kartën e debitit, krahasuar me të dhënat e valëve të mëparshme (52% e përdoruesve të bankave përdorin aktualisht kartën e debitit në vitin 2022, krahasuar me 44% në valën e dytë dhe 46% në valën e parë).
- Nga ana tjetër, ka një rënie të numrit të personave që aktualisht përdorin produkte të tjera përveç kartës së debitit, si kartë krediti, llogari kursimi, kredi konsumatore/personale dhe kredi për shtëpi.

Siguria në industri

Sa besim keni tek industritë e mëposhtme:

Në një shkallë nga 1=aspak në 7=plotësisht




- Të dhënat tregojnë se **sektori bankar** si në valët e mëparshme është industria ku individët besojnë më shumë në krahasim me industritë e tjera (34% e të anketuarve besojnë me 6 dhe 7 në shkallën nga një deri në shtatë, ku shtatë është plotësisht dhe një aspak).
- Industria e dytë më e besuar është **Banka e Shqipërisë**, me 29% që deklarojnë se besojnë “plotësisht” ose “disi”.
- **Partitë politike** janë industria më pak e besuar (vetëm 5% deklarojnë se kanë besim “plotësisht” ose “disi”).

Siguria në industri

Sa besim keni tek industritë e mëposhtme:

Në një shkallë nga 1=aspak në 7=plotësisht




Siguria në industri

Ju shprehët një vlerësim për sektorin bankar. A mund të shpjegoni arsyen që përcakton shkallën e besimit tuaj tek bankat në Shqipëri?

Nxitësit pozitiv



Nxitësit negativ




- Arsyeja kryesore që i nxit përdoruesit e bankave t'u besojnë bankave në Shqipëri është besueshmëria (Siguria/besueshmëria/korrektësia).
- Rreth 6% përmendin se janë **“përgjithësisht të kënaqur”** si një shtytës pozitive dhe rreth 5% përmendin **“ofrimin e shërbimeve cilësore”**.
- Ndër arsyet të përmenduar si nxitës negativ ndaj besueshmërisë të bankave në Shqipëri janë **“mosbesueshmëria”** (29%), **“kosto të ndryshme bankare”** (8%) dhe **“mungesa e transparencës”** (7%)

Siguria në industri

Sipas rajonit

Sa besim keni tek industritë e mëposhtme:

Në një shkallë nga 1=aspak në 7=plotësisht




- Gjetjet e anketës tregojnë se ka një ndryshim të rëndësishëm midis rajoneve në nivelin e besimit në industri të ndryshme.
- Në përgjithësi, të anketuarit që jetojnë në Tiranë kanë një siguri/besim më të ulët në secilën prej industrive të listuara në pyetësor, krahasuar me të anketuarit që jetojnë në rajonet e tjera.

Besimi në industri

Krahasim me valët e kaluara

Sa besim keni tek industritë e mëposhtme:

Në një shkallë nga 1=aspak në 7=plotësisht






- Në krahasimin e të dhënave me valën e dytë, nuk vihet re ndonjë ndryshim i rëndësishëm ndaj nivelit të besimit në sektorin bankar (përmirësim prej 2%).
- Ka një rritje të besimit në *institucionet e arsimit* dhe në *sistemin gjyqësor*, ndërsa ka një rënie të nivelit të besimit *te partitë politike*.

Shënim: Merren në konsideratë vetëm deklaratat që janë pjesë e dy studimeve. Kjo pyetje nuk ishte pjesë e studimit të valës së parë.

Besimi në bankë

Sa i besoni bankës suaj kryesore?

1=aspak besim në 7=plotësisht besim



- Në pyetjen se sa i besojnë të anketuarit bankës së tyre kryesore, të dhënat tregojnë se në total vlerësimi për bankën kryesore është mbi mesataren (5.6 nga 7).
- Të anketuarit që jetojnë në zonat e fshatit, me shkollë të mesme ose arsim të ulët dhe ata që jetojnë në rajone të tjera nga Tirana priren të kenë një nivel më të lartë besimi në bankën e tyre kryesore.


Besimi në bankë

A mund të shpjgoni arsyen që përcakton shkallën e besimit në bankën tuaj kryesore?

Nxitësit pozitiv



Nxitësit negativ




- Kur u pyetën për arsyen kryesore që përcakton shkallën e besimit në bankën e tyre kryesore, 34% e të anketuarëve përmendin **“sigurinë/besueshmërinë/korrektësinë”**.
- Rreth 16% përmendin se janë **përgjithësisht të kënaqur** si një shtytës pozitiv dhe rreth 11% përmendin **“ofrimin e shërbimeve cilësore”**.
- Ndër faktorët negativë më të përmendur për mosbesimin e bankës së tyre kryesore janë **“mosbesueshmëria”** (11%), **“kostot e ndryshme bankare”** (4%) dhe **“mungesa e transparencës”** (3%).

Besimi në bankë

Krahasim

Krahasimi ndërmjet bankës kryesore, Bankës së Shqipërisë dhe sektorin bankar.

1=aspak besim në 7=plotësisht besim




- Të dhënat tregojnë se niveli i sigurisë/besimit të përdoruesve të bankave është më i lartë për bankën e tyre kryesore sesa për sektorin bankar dhe Bankën e Shqipërisë.
- Niveli i besimit në bankën e tyre kryesore është 5.6/7, që është 24% më i lartë se vlerësimi për Bankën e Shqipërisë dhe rreth 19% më i lartë se ai për Sektorin Bankar.

Besimi në bankë

Krahasim me valët e kaluara

Sa i besoni bankës suaj kryesore?

1=aspak besim në 7=plotësisht besim




- Duke krahasuar të dhënat me valën e dytë, nuk vërehet ndonjë ndryshim i rëndësishëm në nivelin e besimit në bankën kryesore të të anketuarit (është vetëm një përmirësim me 0.15/7 pikë ose 2% rritje).

Shënim: Kjo pyetje nuk ishte pjesë e studimit të valës së parë.

Vlerësimi i sektorit bankar

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto pohime në lidhje me bankën tuaj kryesore



- Të anketuarve iu paraqit një listë me deklarata për bankën e tyre kryesore dhe u pyetën nëse pajtohen me to apo jo.
- Gjetjet e anketës tregojnë se pohimi me të cilin të anketuarit pajtohen më së shumti është: *“Është lehtësisht e arritshme në internet (mobile/online banking)”* (93%, *“shumë dakord”* ose *“deri diku dakord”*).
- Deklarata e dytë më e të cilën të anketuarit pajtohen më shumë është *“Komunikon në një gjuhë që unë kuptoj”* (86% *“shumë dakord”* ose *“deri diku dakord”*).
- Deklarata me të cilin të anketuarit pajtohen më pak është *“Më ndihmon të marr vendime financiare”* (vetëm 54% *“shumë dakord”* ose *“deri diku dakord”*).
- Duhet të theksohet se më shumë se gjysma e të anketuarve pajtohen me të gjitha pohimet e renditura në pyetësor.

Vlerësimi i sektorit bankar

Sipas rajonit

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto pohime në lidhje me bankën tuaj kryesore




- Ndarja e të dhënave sipas rajoneve tregon se të anketuarit nga qarqet e tjera (jo nga Tirana) priren të bien dakord më shumë se ata që jetojnë në Tiranë.
- Diferenca më e madhe vihet re në deklaratën “Më ndihmon në marrjen e vendimeve financiare”, ku të anketuarit me banim në Tiranë japin një vlerësim 3.3 nga 5, krahasuar me 3.8 nga 5 për të anketuarit që jetojnë në rajone të tjera.

Vlerësimi i sistemit bankar

Krahasim me valët e kaluara

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto pohime në lidhje me bankën tuaj kryesore




- Në krahasimin e të dhënave me valën e dytë vihet re një rritje e nivelit të pajtimit në lidhje me pohimin “Është lehtësisht e aksesueshme në internet (mobil/online banking)” (rritje me 0,21/5 pikë ose 4,2%).

Shënim: Merren në konsideratë vetëm deklaratat që janë pjesë e dy studimeve. Kjo pyetje nuk ishte pjesë e studimit të valës së parë.

Transparenca e bankës

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto deklarata për bankën tuaj?




- Gjetjet e anketës tregojnë se deklarata e transparencës së bankës për të cilën të anketuarit pajtohen më shumë për bankën e tyre është "Informacioni nga banka është qartësisht i lexueshëm dhe i kuptueshëm" (79% "shumë dakord" dhe "deri diku dakord").
- Deklarata e dytë më e dakordësuar për transparencën e bankës është "Banka më ofron shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm mbi produktet e saj" (73% "shumë dakord" dhe "deri diku dakord").
- Deklarata me të cilën përdoruesit e bankës pajtohen më së paku është "Banka më ofron qasje në informacionet e nevojshme për të zbuluar nëse është financiarisht e shëndoshë" (56% "shumë dakord" dhe "deri diku dakord").

Transparenca e bankës

Sipas rajonit

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto deklarata për bankën tuaj?




- Gjetjet e anketës tregojnë një ndryshim të rëndësishëm midis të anketuarve që jetojnë në Tiranë dhe atyre që jetojnë në rajone të tjera.
- Të anketuarit që jetojnë në rajone të tjera përveç Tiranës pajtohen dukshëm më shumë me deklaratat për transparencën e bankës, krahasuar me të anketuarit që jetojnë në Tiranë.

Transparenca e bankës

Krahasim me valët e kaluara

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto deklaratata për bankën tuaj?




- Nuk ka ndryshim të rëndësishëm të rezultateve për transparencën e bankës në krahasim me valën e dytë.

Shënim: Kjo pyetje nuk ishte pjesë e valës së parë të studimit.

Ndershmëria e bankës

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto deklarata për bankën tuaj?

Aspak dakod Deri diku jo dakod Neutral Deri diku dakord Shumë dakord ND




- Të anketuarve iu prezantuan disa deklarata për ndershmërinë e bankës.
- Gjetjet e anketës tregojnë se deklarata e ndershmërisë së bankës për të cilën të anketuarit pajtohen më shumë është "Me bankën mund të jem i sigurt që do të marr shërbimin që paguaj" (75% "shumë dakord" dhe "deri diku dakord").
- Pohimi me të cilin të anketuarit pajtohen më pak është "Banka kontribuon duke investuar në projekte dhe sponsorizime me qëllim të përfitimit të të gjithë komunitetit" (42% "shumë dakord" dhe "deri diku dakord").
- Për t'u theksuar është përqindja e lartë e të anketuarve që zgjedhin "nuk e di".

Ndershmëria e bankës

Sipas rajonit

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto deklarata për bankën tuaj?




- Analizimi i të dhënave sipas rajoneve, tregon se të anketuarit nga Tirana priren të mos pajtohen më shumë në lidhje me deklaratat për ndershmërinë e bankës.
- Ka një ndryshim të rëndësishëm në nivelin e pajtimit për secilin prej pohimeve në lidhje me transparencën e bankës midis të anketuarve nga Tirana dhe atyre nga qarqet e tjera.

Ndershmëria e bankës

Krahasim me valët e kaluara

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto deklarata për bankën tuaj?




○ Nuk ka dallim të rëndësishëm për ndershmërinë e bankës në krahasim me të dhënat e valës së dytë.

Shënim: Kjo pyetje nuk ishte pjesë e vale së pare të studimit.

Kontakti me bankën

Total dhe sipas gjinisë

Me cilën nga mënyrat e mëposhtme keni kontaktuar me bankën gjatë 6 muajve të fundit?




- Shumica e njerëzve (74%) ende kontaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejt me bankën duke *shkuar në degë*.
- Pothuajse gjysma e të anketuarve (46%) kontaktojnë bankën përmes *mobile banking*.
- Nuk ka dallime të rëndësishme midis meshkujve dhe femrave në lidhje me mënyrat e kontaktit me bankën.

Kontakti me bankën

Sipas rajonit

Me cilën nga mënyrat e mëposhtme keni kontaktuar me bankën gjatë 6 muajve të fundit?




- Të dhënat tregojnë se të anketuarit që jetojnë në Tiranë kanë kontaktuar bankën nëpërmjet *mobile banking* më shumë se në qarqet e tjera (56% në Tiranë, kundrejt 42% në qarqe të tjera), nëpërmjet *shërbimeve të Call Center* (21% në Tiranë, kundrejt 7% në të tjera rajone).

Kontakti me bankën

Krahasim me valët e kaluara


Me cilën nga mënyrat e mëposhtme keni kontaktuar me bankën gjatë 6 muajve të fundit?



- Krahasuar me të dhënat e valës së dytë, gjetjet e anketës tregojnë se ka një rritje të kontaktit me bankën.
- Rritja më e madhe vihet re tek kontakti përmes *mobile banking* (20% në 2019, kundrejt 46% në 2022).

Shpeshtësia e kontaktit

Ju lutem a mund të na thoni se sa shpesh përdorni secilën nga këto mënyra?




- Edhe pse mënyra më e përdorur e kontaktit është “*duke shkuar në degë*”, shpeshtësia e këtij kontakti është më e ulët në krahasim me kontaktin digjital.
- Vetëm 27% e të anketuarëve të cilët kanë kontaktuar bankën duke shkuar në degë gjatë 6 muajve, e bëjnë këtë të paktën *disa herë në muaj*
- Nga ana tjetër, 76% e atyre që e kanë kontaktuar bankën përmes *online banking* e bëjnë këtë të paktën disa herë në muaj, ndërsa 84% e atyre të cilëve e kanë kontaktuar bankën gjatë këtyre 6 muajve përmes *mobile banking* e bëjnë këtë disa here gjatë muajit.

Shpeshtësia e kontaktit

Sipas rajonit

Ju lutem a mund të na thoni se sa shpesh përdorni secilën nga këto mënyra?




- Të dhënat tregojnë se të anketuarit që jetojnë në Tiranë e kontaktojnë më rrallë bankën e tyre kryesore duke shkuar në degë sesa të anketuarit nga rajonet e tjera, përkatësisht 26% kundrejt 28% kontaktojnë të paktën disa herë në muaj.
- E njëjta gjë vlen edhe për kontaktin nëpërmjet *online banking*, përkatësisht 71% në Tiranë kundrejt 78% në rajonet e tjera.
- Nga ana tjetër, të anketuarit që jetojnë në Tiranë kontaktojnë më shpesh bankën e tyre kryesore nëpërmjet *mobile banking* sesa ata që jetojnë në rajone të tjera, përkatësisht 88% kundrejt 82%.

Shpeshtësia e kontaktit

Krahasim me valët e kaluara

Ju lutem a mund të na thoni se sa shpesh përdorni secilën nga këto mënyra?




- Kur krahasohen rezultatet e studimit të viti 2022 me rezultatet e valës së parë, gjetjet e anketës tregojnë se ka një rënie të shpeshtësisë së kontaktit nëpërmjet *mobile banking* dhe mënyrës duke *shkuar në degë*.
- Nga ana tjetër, ka një rritje të shpeshtësisë së kontakteve përmes *online banking*.

Shënim: Kjo pyetje nuk ishte pjesë e valës së dytë të studimit.

Përdorimi i produkteve bankare digjitale


Përdorimi i produkteve bankare digjitale.



- Gjysma e të anketuarve deklarojnë se nuk përdorin online ose mobile banking. Gjysma tjetër (50%) përdorin të paktën *online banking* ose *mobile banking*.
- Katër në dhjetë (39%) të anketuar deklaruan se përdorin vetëm *mobile banking*, ndërsa 4% deklaruan se përdorin vetëm *online banking*.
- Nga ata që përdorin të dyja *online dhe mobile banking* (7%), shumica e tyre (73%) përdorin më shumë *mobile banking*.

Përdorimi i produkteve bankare digjitale


Përdorimi i produkteve bankare digjitale.



- Të dhënat tregojnë se të moshuarit (mbi 44 vjeç), përdoruesit e bankave me shkollë të mesme ose më të ulët, ata që nuk jetojnë në Tiranë dhe ata që jetojnë në zonat e fshatit përdorin më pak se të tjerët *mobile dhe online banking*.
- Përdoruesit e bankave nga Tirana, përdorin dukshëm më shumë *mobile banking* krahasuar me përdoruesit e bankave nga rajonet e tjera, përkatësisht 46% kundrejt 37%.

Përdorimi i produkteve bankare digjitale

Deri në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me këto deklaratat:




